

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, në lidhje me profilet e teknikienëve mjekësorë (mami, imazheri, inferimer në reanimacion, për tregun e punës në sistemin publik shëndetësor) ju sqarojmë si më poshtë:

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor ushtron veprimtarinë e tij në zbatim dhe në përputhje të ligjit nr. 10 383, datë 24.02.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në nenin 10 të këtij ligji parashikohet se Fondi financon paketat e shërbimeve të sigurimit të detyrueshëm, ku përfshihen: vizitat, ekzaminimet dhe trajtimet mjekësore në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor, në spitalet publike dhe jopublike për personat e siguruar.

Në zbatim të ligjit të sipërcituar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 23, datë 18.01.2023 “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor, për vitin 2023”, Fondi lidh kontrata me dhënësit e shërbimit shëndetësor për financimin e paketave të shërbimeve shëndetësore spitalore, të ofruara prej tyre.

Bazuar në Kontratën tip “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore, për vitin 2023”, ndërmjet FSDKSH dhe dhënëseve të shërbimit shëndetësor spitalorë, Neni “Financimi” përcaktohet se: Spitali respekton strukturën e personelit të miratuar nga MSHMS, si dhe zbaton bazën ligjore për pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore të personelit.

Gjithashtu në Aneksin nr. 2, “Pasqyra e burimeve njerëzore”, si pjesë përbërëse e kontratës së financimit të sipërcituar, informacioni që dërgohet në Fond nga Drejtoritë Rajonale të Fondit për spitalet, raportohet sipas shërbimeve mjekësore dhe numrit të përgjithshëm të punonjësve në spitale.

Fondi nuk disponon informacionin sipas kërkesës suaj.